



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr. **64/2024**

Data: **27 Nëntor 2024. Ora: 13:30**

Vendi: **Selia e KQZ**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana

Në takim ishin të pranishëm: Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

### **RENDI I DITËS**

- 
- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
  - 2. Procesverbali nga mbledhja nr. 60 e KQZ.**
- 

### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ**

---

### **3. Autorizimi i u. d Drejtorit të SKQZ për nënshkrimin Marrëveshjes mes KQZ dhe PZAP**

---

### **4. Raport i Këshillave të KQZ**

---

---

## 4.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

4.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikimet teknike për Furnizim me materiale të posaçme për votues të verbër.

4.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve për shërbimet postare.

4.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit për ndërrimin e Qendrës së Votimit.

4.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për shkatërrim të UV Sprej nga zgjedhjet e kaluara.

---

## 5. Të ndryshme

---

### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi**: Kryetari Radoniqi paraqiti rendin e ditës i cili, u aprovua me vota unanime. Pastaj, u miratua procesverbali numër. 60/2024 i mbledhjes së KQZ me një votë kundër! (mos votim: z. Sami Kurteshi).

### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ:**

**Besnik Buzhala**, ud. i kryeshefit të Sekretariatit: Aktivitetet tona janë fokusuar në planin e aktiviteteve zgjedhore. Për ndërrim të QV-ve janë pranuar 2236 kërkesa. Gjithsej, janë aprovuar 2161 kërkesa, ndërsa nuk janë aprovuar 75 kërkesa. Eshtë duke vazhduar edhe periudha për aplikimit të regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës. Kanë aplikuar deri më tani 22 496 persona. Prej tyre, janë aprovuar 21, 067 aplikime. Nuk janë miratuar 1399 kërkesa. Prej aplikuesve, 12, 372 kanë deklaruar se do të votojnë përmes postës duke dërguar dërgesat në postë, 3064 në kutitë postare në Kosovës, dhe 5631 votues fizikisht në përfaqësitë diplomatike.

Raporti, tha z. Buzhala, përmban votues të aprovuar në bazë të shteteve: Gjermania, me 8892, Zvicra me 6112 etj.

Për këto dy periudha sekretariati po pranon thirrje në Shërbimin votues, imella dhe se të gjitha komunikimet dhe shkresat lidhen me këtë proces.

Ilir Gashi: Dua të informohem nga sekretariati lidhur me hapjen e “Kutive postare” në përfaqësitë diplomatike në shtete të ndryshme. Ka kohë ende por a ka filluar procesi, deri ku ka shkuar procesi...?

Besnik Buzhala: Sekretariati përmes një raporti do t’ju informojë sepse nuk kemi ndonjë raport tani.

### **3. Autorizimi i u. d Drejtorit të SKQZ për nënshkrimin Marrëveshjes mes KQZ dhe PZAP**

**Besnik Buzhala:** Kjo pikë ka të bëjë me autorizimin e u. d Drejtorit të SKQZ për nënshkrimin Marrëveshjes me palët e treta. E kemi rastin me PZAP ! Sepse, kemi të bëjmë me dorëheqjen e parevokueshme të u.d. të drejtoreshës së divizionit për buxhet dhe financa dhe, zyrtare kryesore financiare. Sekretariati, është takuar me PZAP dhe ata kanë pranuar që me shkëmbyer zyrtarin kryesor financiar, dhe kërkojmë që të na lejohet arritja e marrëveshjes.

Me 10 vota për, miratohet.

### **4. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikimet teknike për Furnizim me materiale të posaçme për votues të verbër:

**Arianit Elshani:** KOZ-i, ka shqyrtuar këtë pikë. Specifikat, janë të hartuara qysh në shtator. Prandaj, shpresojmë edhe informimin e tyre, njoftimin me procedurave etj. Ne, rekomandojmë që specifikat për furnizim me materiale të posaçme për votues të verbër, të miratohen.

Me 10 vota për, miratohen specifikat.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve për shërbimet postare:

**Arianit Elshani:** U hap më parë kjo temë. Sekretariati ka hartuar specifikat për shërbimin postarë që do të kontraktohet. Në këto specifika, janë hartuar të gjitha veprimet e nevojshme nga ne këtu, e te përfaqësitë diplomatike. Kemi shqyrtuar edhe afatet tona të nevojshme kohore dhe ato të operatorëve lidhur me transferin e materialit – dërgesat.

Diskutuan në këtë temë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, dhe Arianit Elshani. Në fund, u vendos që të lehtësohen kriteret e aplikimit për operatorët që do të konkurrojnë në operacionet, në pikën si më lartë.

Me 10 vota për, miratohen specifikat ( me një rekomandim) për shërbimet postare.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektit për ndërrimin e Qendrës së Votimit:

**Arianit Elshani:** E kemi shqyrtuar edhe këtë projekt, i cili zgjat deri më 26 dhjetor. Deri në këtë datë, të gjithë qytetarët kanë të drejtë të ndryshojnë QV-në. Janë ndërmarrë veprime informuese,

janë dërguar sms, rrjete sociale etj. Në këtë fazë, planifikohen të dërgohen ende sms në IPKO dhe Vala, mesazhe, video spote...

Është një para masë prej: 23, 155 euro.

Në këtë pikë, diskutuan: Fazli Stollaj.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 11 vota për, miratohet projekti për ndërrimin e Qendrës së Votimit.

#### 4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për shkatërrim të UV Sprej nga zgjedhjet e kaluara:

**Arianit Elshani:** Ne në KOZ, tha z. Elshani, i kemi shqyrtuar edhe specifikat e shkatërrimit të UV sprejit që daton nga zgjedhjet e kaluara. Bëhet fjalë për 380 kilogram sasi e uvesprejit me afat të skaduar. Shkatërrimi i këtij materiali të skaduar, ka një kosto prej: 9,900 euro.

Jemi konsultuar me Ministrinë e Ambientit. Ka operatorë të licencuar që mund ta bëjnë këtë veprim-asgjësim. Tani, janë inisuar procedurat dhe është e qartë se si duhet të veprohet. Si këshill, rekomandojmë shkatërrimin e këtij materiali që është i vendosur në QNR.

Me 11 vota për, miratohet projekti për ndërrimin e Qendrës së Votimit.

#### **Të ndryshme !**

**Sami Kurteshi:** E kemi një përvojë dhe praktikë, mirëpo nuk kemi një “vendim” për marrjen e vendimeve. Pra, marrim vendime dhe nuk kemi një rregullore se si, marrim vendimeve, miratime, kundërshtime... Edhe, vendimet “on linë” që i marrim...

**Kreshnik Radoniqi:** Kemi me e ndryshue rregulloren e punës. Mendoj që, do të jetë kjo çështje, janë do specifika që do ti ndajmë bashkë...